

URDHËR
Nr. 65, datë 20.1.2014

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 15.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të pikës V/2, germa “a”, të vendimit nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjiellës-Kanalizimeve jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km, të lëshohen nga drejtori i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjiellës-Kanalizimeve.

2. Në ushtrimin e kësaj kompetence, drejtori i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjiellës-Kanalizimeve, të zbatojë kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar.

3. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjiellës-Kanalizimeve për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto